



NEWSLETTER E DIASPORËS

PËRFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE TË NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

Njësia e Diasporës në Bashki / Ministri Majko takim me institucionet përgjegjëse




Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko zhvilloi një takim me Bekim Muratin, Drejtor i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, nënkryetarin e Bashkisë Tiranë, Arbjan Mazniku dhe dy përfaqësuesit e GIZ-it, Jonny Bodo dhe Amir Haxhikadrija. Në takim u bisedua mbi përfshirjen në gamën e funksioneve të bashkive, të fushës së Diasporës dhe migracionit si dhe përditësimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 456, datë 10.06.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 910, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave, "Për çështjet objekt konsultimi dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar. Gjithashtu në qendër të takimit ishte dhe Memorandumi i Bashkëpunimit për bashkërendimin e punës për ngritjen e Strukturës Administrative për Diasporën dhe Migracionin në qeverisjen vendore ndërmjet Ministrisë së Brendshme, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrinë të Shtetit për Diasporën dhe Shoqatës për Autonomi Vendore.

Vota e Diasporës Shqiptare



Të interesuarit për të drejtën e votes në migracion, mund të gjejnë propozimet që i janë dërguar Komisionit të Reformës Zgjedhore [këtu](#):

Publikohet manuali "Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë"



Manuali është një botim i veçantë elektronik, i cili përmbledh aktet rregulluese për krijimin e Bazës së të dhënave shtetërore të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë dhe shtetasve shqiptarë, të cilët kanë përfituar bursat e studimit të cilat i ofrohen Shqipërisë nga shtete, organizata ndërkombëtare dhe jofitimprurëse në baze të marrëveshjeve të nënshkuara apo dokumente të tjera ku Republika e Shqipërisë është palë.

"Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës"



"Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës" është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetimin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionale të ndryshme në diasporë.

FSHZHD / Marrëveshje bashkëpunimi me Prointegra

Fondi Shqiptar për Zhvillim e Diasporës firmosi një marrëveshje bashkëpunimi me kryetarin e shoqatës Prointegra në Zvicër, z. Osman Osmani. Kjo marrëveshje synon mbështetjen dhe nxitjen e zhvillimit socio-ekonomik e kulturor të shqiptarëve në Republikën e Shqipërisë, Republikën e Kosovës dhe jashtë saj. Drejtoresha e Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, znj. Majlinda Vogli, vlerësoi gadishmërinë e këtij bashkëpunimi dhe shfrytëzimin e burimeve të përbashkëta për krijimin dhe plotësimin e rrjetit të profesionistëve të Diasporës shqiptare.



Platforma Digjitale e Veprave Shqiptare



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për here të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen.

Mbërrijnë në Ukrainë fjalorët dhe pajisjet për Qendrën e Informacionit të Shqipërisë në Universitetin Humanitar Shtetëror të Izmailit



Mbërrijnë në Ukrainë 660 Fjalorët dygjuhësh Shqip-Ukrainisht të botuar nga Qendra e Botimeve për Diasporën dhe pajisje për Qendrën e Informacionit të Shqipërisë në Universitetin Humanitar Shtetëror të Izmailit. Fjalorët dhe materialet e tjera janë dërguar nga Agjencia Kombëtare e Diasporës në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit me qëllim krijimin e Qendrës së Informacionit të Shqipërisë në këtë universitet, për të nxitur organizimin e aktiviteteve të përbashkëta në ruajtjen e gjuhës shqipe, kulturës, traditave dhe trashëgimisë kulturore shqiptare në Ukrainë.

D Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

KKD / Lazim Destani takim me Presidentin e Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi



Anëtari i Këshillit Koordinues të Diasporës, si dhe Kryetari i Nderit i Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare, z. Lazim Destani, zhvilloi një takim me Presidentin e Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi. "Ai ka dhënë kontribut shumë të madh për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, për demokracinë në Shqipëri, për afirmimin e shqiptarëve në Maqedoni dhe për kauzën kombëtare në përgjithësi. Lazim Destani është humanist i madh dhe personalitet me vlera të larta njerëzore", -shprehët Presidenti Thaçi.

"Raporto" problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):